



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE

DREJTORIA E MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 08.10.2021

Lënda: Kthim përgjigje

**Z. Andrelin Prifti**

**GAZETAR**

**EMISIONI “STOP”**

*Adresa: Televizioni Kombëtar “KLAN”,*

*Rruga: “Aleksander Moisiu”, nr. 97, Tiranë.*

I nderuar z. Prifti,

Në përgjigje të kërkesës Tuaj të datës 27.09.2021, të regjistruar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore me nr. 5923 prot., datë 27.09.2021, me anë të së cilës kërkon informacion për periudhat kontributive të derdhura në emër të shtetases Lumturi (Lume) Rama, ju informojmë se:

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Instituti i Sigurimeve Shoqërore është i detyruar të ruajë konfidencialitetin dhe të sigurojë mbrojtjen, aksesin ose përhapjen e të dhënave personale të klienteve të saj nga persona të paautorizuar dhe për këtë arsye e ka të pamundur t’ju vërë në dispozicion informacionin e kërkuar.

*Në kuptim të ligjit të sipërcituar, “e dhënë personale” është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.*

Informacioni i kërkuar prej jush mund t'i vihet në dispozicion vetëm personit, të cituar në shkresën tuaj, nëpërmjet kërkeses së nënshkruar prej saj apo përfaqësuesve të autorizuar, sipas neneve 64 e në vijim të Kodit Civil.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije se informacionin për pagat dhe derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, çdo individ mund t'a aksesoj (personalisht ose nëpërmjet një personi të autorizuar) edhe nga portali e-albania, tek shërbimet: "Deklarimi dhe pagimi i kontributeve nga punëdhënësit" dhe "Vërtetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore (pas datës 01.01.2012)

Ju falenderojmë për mirëkuptimin!

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**Astrit Hado**